



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

## Përmbajtja

|      |                                                                     |   |
|------|---------------------------------------------------------------------|---|
| I.   | H y r j e.....                                                      | 2 |
| II.  | Raporti i monitorimit të buxhetit të INSTAT Janar-Dhjetor 2022..... | 2 |
| III. | Analiza e realizimit të buxhetit të INSTAT Janar-Dhjetor 2022 ..... | 4 |

### Anekset bashkëlidhur:

- Aneksi Nr. 1-Raporti i shpenzimeve sipas programeve
- Aneksi Nr. 2-Raporti i shpenzimeve të programit sipas artikujve buxhetorë
- Aneksi Nr. 3-Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit
- Aneksi Nr. 4-Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit
- Aneksi Nr. 5-Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj

## I. HYRJE

Monitorimi i buxhetit të INSTAT për vitin 2022 përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Strukturat e INSTAT-it kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit të INSTAT-it të përfshirë në Programin e Statistikave Zyrtare 2022-2026.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të INSTAT-it të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor, nëpërmjet treguesve të planifikuar, duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

## II. RAPORTI I MONITORIMIT TË BUXHETIT TË INSTAT JANAR-DHJETOR 2022

### **Programi 01320 “Veprimtaria Statistikore”**

Buxheti i akorduar për programin “*Veprimtaria statistikore e INSTAT-it*”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit të hartuar gjatë procesit të PBA 2022-2024 dhe është në funksion të realizimit të Politikës së Programit.

INSTAT, mbështetur në Ligjin Nr.17, datë 05.04.2018 “Për Statistikat Zyrtare” është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Misioni i tij është të prodhojë statistika asnjansë, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Programi i Statistikave Zyrtare, 2022-2026, përcakton strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor, duke synuar përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për statistika cilësore. Programi përmban aktivitetet statistikore, të cilat janë në funksion të zbatimit të strategjisë dhe prioritetëve të institucionit.

Politika e këtij programi konsiston në prodhimin e të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke u përqëndruar në fenomene thelbësore për vendimmarrësit, si dhe duke respektuar të drejtën e qytetarëve për të dhëna zyrtare, në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Institucionit, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në implementimin e objektivave që bëjnë të mundur përmbushjen e standardeve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

të vendosura nga BE, në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të përdorimit të burimeve njerëzore dhe financiare të INSTAT-it.

**Politika e këtij institucioni është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:**

- Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e me cilësi e të dhënave statistikore në fushat ekonomike, sociale, të zhvillimit demografik dhe mjedisor në nivel qendror dhe lokal.
- Përdorimi i burimeve të të dhënave dhe instrumenteve të duhura, për të përmirësuar prodhimin dhe cilësinë e treguesve dhe shërbimeve statistikore.
- Përmirësimi profesional dhe organizativ i Sistemit Kombëtar Statistikor.
- Zhvillimi i sistemeve inovative ITC për përpunimin statistikor, shkëmbimin e të dhënave dhe komunikimin.

**Menaxhimi i buxhetit është fokusuar në financimin e shpenzimeve në funksion të përmbushjes së objektivave prioritare strategjike të mëposhtme:**

- Përmirësimin e cilësisë së realizimit të vërtetimeve, duke përdorur teknika moderne për grumbullimin e përpunimin e të dhënave, si dhe duke rritur kapacitetin profesional të punonjësve mbështetës nëpërmjet trajnimeve.
- Zgjerimin e fushës së mbulimit me aktivitete të reja sipas kërkesave të përdoruesve dhe të rrisë numrin e njësive statistikore (njësi ekonomike dhe familje) të intervistuar në vërtetimet statistikore.
- Paraqitjen e një produkti statistikor të përmirësuar cilësor dhe sasior tek përdoruesit nëpërmjet publikimeve statistikore, zhvillimit të konferencave, interpretimit të tyre me mjete të ndryshme komunikimi.
- Mirëmenaxhimin e institucionit, duke aplikuar një menaxhim të lartë administrativ të burimeve financiare dhe njerëzore.
- Përditësimin e infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e proceseve të përpunimit të të dhënave.
- Pajisjen e punonjësve me bazën e nevojshme materiale dhe kompjuterike për përpunimin e të dhënave, si dhe të krijohen kushte të përshtatshme pune për punonjësit nëpërmjet mobilitetit të zyrave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

### III. ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË INSTAT JANAR-DHJETOR 2022


#### Shpenzimet faktike të Programit sipas artikujve për vitin 2022

Buxheti i Institutit të Statistikave për vitin 2022, i miratuar me Ligjin Nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i ndryshuar është **745,200.4** mijë lekë.

Këto fonde, INSTAT i administron në një program “Veprimtaria Statistike”, si më poshtë:

| Mijë lekë |                                      |                                  |                                  |
|-----------|--------------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|
| Artikulli | Emërtimi i artikullit                | Buxheti fillestar<br>vjetor 2022 | Buxheti rishikuar<br>vjetor 2022 |
| 6000000   | Pagat                                | 529,488.0                        | 423,210.8                        |
| 6010000   | Kontributi i sigurimeve shoqërore    | 89,485.0                         | 71,387.9                         |
| 6020000   | Mallra dhe shërbime                  | 647,853.0                        | 49,643.7                         |
| 6040000   | Transferta korrente të brëndshme     | 1,574.0                          | 1,574.0                          |
| 6060000   | Transferta buxhetesh familjare       | 0.0                              | 12,884.0                         |
|           | <b>Totali i shpenzimeve korrente</b> | <b>1,268,400.0</b>               | <b>558,700.4</b>                 |
| 2310000   | Investime                            | 700,000.0                        | 186,500.0                        |
|           | <b>TOTALI</b>                        | <b>1,968,400.0</b>               | <b>745,200.4</b>                 |

Pesha specifike sipas zërave të shpenzimeve, të planifikuara mbi totalin e shpenzimeve paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:



Siç shihet nga grafiku “Paga Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” zë 66 % të buxhetit, “Mallra dhe Shërbime” zë 9 % të buxhetit dhe “Investime” zë 25 % të buxhetit.

**Realizimi i shpenzimeve sipas artikujve për vitin 2022 krahasuar me planin e vitit**, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

| “Veprimtaria statistikore” |                                           |                          |                     | Mijë lekë                        |
|----------------------------|-------------------------------------------|--------------------------|---------------------|----------------------------------|
| Artikulli                  | Emërtimi i artikullit                     | Plani vjetor i rishikuar | Fakti 12-mujor 2022 | % e Realizimit plan/fakt12-mujor |
| 6000000                    | Paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 494,598.7                | 489,927.6           | 99.1                             |
| 6020000                    | Mallra dhe shërbime                       | 49,643.7                 | 46,591.9            | 93.9                             |
| 6040000                    | Transferta korrente të brëndshme          | 1,574.0                  | 579.5               | 36.8                             |
| 6060000                    | Transferta për buxhete familjare          | 12,884.0                 | 12,708.1            | 98.6                             |
|                            | <b>Totali i shpenzimeve korrente</b>      | <b>558,700.4</b>         | <b>549,807.1</b>    | <b>98.4</b>                      |
| 2310000                    | Investime                                 | 14,500.0                 | 11,718.5            | 80.8                             |
|                            | <b>Totali i buxhetit</b>                  | <b>573,200.4</b>         | <b>561,525.6</b>    | <b>97.9</b>                      |
|                            | <b>Financim i huaj</b>                    | <b>172,000.0</b>         | <b>170,143.4</b>    | <b>98.9</b>                      |
|                            | <b>Totali të ardhura jashtë limiti</b>    | <b>0.0</b>               | <b>9,111.8</b>      | <b>0.0</b>                       |
|                            | <b>TOTALI</b>                             | <b>745,200.4</b>         | <b>740,780.7</b>    | <b>99.4</b>                      |

#### 1- **“Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore”. Artikulli 600-601**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit i ndryshuar për vitin 2022 për zërin “Paga, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” është 494,498.7 mijë lekë, nga të cilat janë shpenzuar 489,927.6 mijë lekë, ose 99.1 % e planit 12-mujor 2022.

Në zërin “Paga, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” përfshihen pagat e punonjësve të strukturës të INSTAT-it, si dhe pagat e punonjësve me kontratë të përkohshme pune, për organizimin dhe zhvillimin e anketave, mbështetur në përllogaritjen e numrit të punonjësve të domosdoshëm sipas pozicioneve, duke mbajtur parasysh kontributin e çdo pozicioni në secilën anketë.

Sipas aktit normativ Nr. 3 datë 12.03.2022 ka pasur ndryshime në buxhet për zërin “Paga, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” u pakësuan 15,474 mijë lekë, shkresa Nr. 1404 Prot. datë 05.08.2022 Institutit të Statistikave u pakësuan 25,300 mijë lekë dhe u shtuan të “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera”, aktit normativ Nr. 17 datë 01.12.2022 ku u pakësuan 88 milion lekë si dhe shkresa Nr. 1705/1 datë 10.02.2022 e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ku u shtuan 4,400 mijë lekë për dixhitalizimin e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

pyetësorit të Këshillimit Kombëtar. Mos realizimi ka ardhur kryesisht për shkak të shtyrjes së Censit të Popullsisë dhe Banesave dhe nga mos plotësimi mesatarisht i 20 vendeve vakante të strukturës organike.

Gjatë 12-mujorit 2022 janë zhvilluar 45 procedura konkurimi, ku 33 procedura kanë përfunduar me fitues, 12 procedura pa fitues dhe 33 largime (dorëheqje, dalje në pension pleqërie dhe pezullim statusi).

## **2- “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera”. Artikulli 602**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit i ndryshuar për vitin 2022 për zërin “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” është 49,643.7 mijë lekë dhe janë shpenzuar 46,591.9 mijë lekë ose 93.9% e planit 12-mujor.

Sipas aktit normativ Nr. 3 datë 12.03.2022 ka pasur ndryshime në buxhet për zërin “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera” për periudhën Janar-Dhjetor, ku u pakësuan 64,785 mijë lekë, aktit normativ Nr. 12 datë 29.07.2022 ka pasur ndryshime ku u pakësuan 553 milion, aktit normativ Nr. 17 datë 01.12.2022 ku u pakësuan 6 milion lekë si dhe shkresa Nr. 1705/1 datë 10.02.2022 e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ku u shtuan 900 mijë lekë për dixhitalizimin e pyetësorit të Këshillimit Kombëtar.

Pakësimi për zërin Mallra dhe Shërbime të Tjera është bërë për shkak të shtyrjes së Censit të Popullsisë dhe Banesave ku rreth 80 % e zënë pagat e anketuesve të Censit.

## **3- “Transferta korrente të brendshme”. Artikulli 604**

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2022 për zërin “Transferta korrente të brendshme” është 1,574 mijë lekë dhe nga këta janë shpenzuar 579.5 mijë lekë, ose 36.8 % e fondit 12-mujor. Për periudhën Janar-Dhjetor 2022 janë realizuar 3 mbledhje për Këshillin e Statistikës.

## **4- “Transferta për buxhete familjare”. Artikulli 606**

Fondet e akorduara për zërin Fondi i Veçantë janë bërë në bazë të shkresës Nr. 1468/1 datë 02.02.2022 ku u shtuan 650 mijë lekë, shkresës Nr. 1704/1 datë 10.02.2022 ku u shtuan 624 mijë lekë me transferim fondi nga llogaria 602 te llogaria 606 si dhe aktit normativ Nr. 19 datë 29.12.2022 ku u shtuan 11,610 mijë lekë.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2022 nga Fondi i veçantë janë shpenzuar 12,708 mijë lekë, ose 98.6 %. Keto fonde janë përdorur për daljen në pension të 7 punonjësve, 2 raste fatkeqësie, për kompesim të telefonisë celulare dhe për zbatimin e V.K.M-së 898 datë 29.12.2022 “Mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës.

## 5- “Shpenzime për Investime”. Artikulli 231

Bazuar në ligjin Nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, plani i buxhetit i ndryshuar për investime është në shumën 186,500 mijë lekë, nga të cilat 14,500 mijë lekë për Investime me Financim të Brendshëm dhe 172,000 mijë lekë për Investime me Financim të Huaj.

Ndryshimet në buxhet për zërin Investime janë bërë sipas aktit normativ Nr. 12 datë 29.07.2022 ku u pakësuan 233 milion lekë, aktit normativ Nr. 17 datë 01.12.2022 ku u pakësuan 52,500 mijë lekë. Realimi i Investimeve me Financim të Brendshëm është 11,718.5 mijë lekë ose 80.8 %.

Pakësimi për zërin Investime është bërë për shkak të mos zhvillimit të procedurës së tenderimit “Blerje Paisje Kompjuterike tableta”.

Realizimi i shpenzimeve me Financim të Huaj për vitin 2022 është 170,143 mijë lekë ose 98.9 %

Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit për vitin 2022 janë 9,112 mijë lekë.

Realizimi i Investimeve me Financim të Brendshëm sipas zërave për periudhën Janar-Dhjetor 2022 është si më poshtë:

| Emertimi                   | Plani 12-mujor  | Fakti 12-mujor  | Mijë lekë   |
|----------------------------|-----------------|-----------------|-------------|
|                            |                 |                 | Realizimi % |
| Blerje Liçenca             | 3,600.0         | 3,381.7         | 93.9        |
| Blerje Paisje Kompjuterike | 2,100.0         | 0.0             | 0.0         |
| Likujdim TVSH              | 8,800.0         | 8,336.8         | 94.7        |
| <b>Totali i Investime</b>  | <b>14,500.0</b> | <b>11,718.5</b> | <b>80.8</b> |

Realizimi i shpenzimeve me Financim të Huaj për vitin 2022 është 170,143 mijë lekë ose 98.9 %.

Projektet që menaxhohen nga INSTAT-i janë si më poshtë:

1. SALSTAT - Statistika të Forta Vendore.
2. Mbështetje për CENS 2022
3. IPA 2019 Multi-Beneficiary Statistical Cooperation Programme
4. Sida Direct Funding - Instat Census 2022

## 6- Shpenzime nga të “Ardhurat jashtë limitit”

Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit për periudhën Janar-Dhjetor 2022 janë 9,111.8 mijë lekë për shpenzime operative.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë likujduar të gjitha detyrimet ndaj të tretëve sipas afateve ligjore.

INSTAT-i nuk ka detyrime të prapambetura.

Realizimi i shpenzimeve *sipas produkteve* për periudhën Janar-Dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:

| Llogaria Ekonomike | Produkti                                            | Output Code    | Plan Fillestar     | Plan rishikuar   | Fakt 12-mujor    | % Realizimi |
|--------------------|-----------------------------------------------------|----------------|--------------------|------------------|------------------|-------------|
| 6000000            | Njësi statistikore të vrojtuar                      | 95001AA        | 279,864.0          | 211,086.8        | 210,978.8        | 99.9        |
| 6010000            | Njësi statistikore të vrojtuar                      | 95001AA        | 48,381.0           | 35,783.9         | 35,054.5         | 98.0        |
| 6020000            | Njësi statistikore të vrojtuar                      | 95001AA        | 562,618.0          | 2,308.7          | 1,439.3          | 62.3        |
| 2310000            | Financim I huaj                                     | GM50002        | 400,000.0          | 172,000.0        | 170,143.4        | 98.9        |
| 6060000            | Njësi statistikore të vrojtuar                      | 95001AA        | 0.00               | 9,130.0          | 9,120.0          | 99.9        |
|                    | <b>Totali i njesive statistikore te vrojtuar</b>    |                | <b>1,290,863.0</b> | <b>430,309.4</b> | <b>426,736.0</b> | <b>99.2</b> |
| <b>6020000</b>     | <b>Te dhena statistikore te publikuara</b>          | <b>95001AB</b> | <b>0.00</b>        | <b>0.0</b>       | <b>0.0</b>       | <b>0.0</b>  |
| 6000000            | Personel i trajnuar                                 | 95001AC        | 249,624.00         | 212,124.0        | 209,026.9        | 98.5        |
| 6010000            | Personel i trajnuar                                 | 95001AC        | 41,104.00          | 35,604.0         | 34,867.4         | 97.9        |
| 6020000            | Personel i trajnuar                                 | 95001AC        | 85,235.00          | 47,335.0         | 45,152.5         | 95.4        |
| 6040000            | Personel i trajnuar                                 | 95001AC        | 1,574.00           | 1,574.0          | 579.5            | 36.8        |
| 6060000            | Personel i trajnuar                                 | 95001AC        | 0.00               | 3,754.0          | 3,588.1          | 95.6        |
|                    | <b>Totali Personel i trajnuar</b>                   |                | <b>377,537.0</b>   | <b>300,391.0</b> | <b>293,214.4</b> | <b>97.6</b> |
| <b>6020000</b>     | <b>Auditime te kryera.</b>                          | <b>95001AD</b> | <b>0.0</b>         | <b>0.0</b>       | <b>0.0</b>       | <b>0.0</b>  |
| 2310000            | Infrastruktura e nevojshme software- te perditsuara | M500011        | 3,850.00           | 3,850.0          | 3,381.7          | 87.8        |
| 2310000            | Pajisje te teknologjise se informacionit te blera   | M500002        | 282,750.00         | 1,850.0          | 0.0              | 0.0         |
| 2310000            | TVSH                                                | M500005        | 13,400.00          | 8,800.0          | 8,336.7          | 94.7        |
|                    | <b>Totali i investimeve nga buxheti</b>             |                | <b>300,000.0</b>   | <b>14,500.0</b>  | <b>11,718.5</b>  | <b>80.8</b> |
|                    | Te ardhura jashte limitit                           |                | 0                  | 0.0              | 9,111.8          | 0.0         |
|                    | <b>TOTALI</b>                                       |                | <b>1,968,400.0</b> | <b>745,200.4</b> | <b>740,780.7</b> | <b>99.4</b> |

Shpenzimet për produktin “Njësi statistikore të vrojtuar” janë 426,736 mijë lekë ose 99.2 % e krahasuar me planin vjetor. Ndërsa shpenzimet për produktin “Personel i trajnuar” janë 293,214.4 mijë lekë ose 97.7%.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Realizimi në sasi sipas **treguesit të performancës/produktit** për periudhën 12-mujore paraqitet si më poshtë:

| Nr. | Emërtimi i Treguesit të Performancës/Produktit | Plan    | Fakt 12-mujor | % Realizimit |
|-----|------------------------------------------------|---------|---------------|--------------|
| 1   | Njësi statistikore të vrojtura                 | 254,264 | 213,820       | 84.1         |
| 2   | Të dhëna të publikuara                         | 167     | 165           | 98.8         |
| 3   | Personel i trajnuar                            | 236     | 216           | 91.5         |
| 4   | Auditime të kryera                             | 7       | 6             | 85.7         |
| 5   | Blerje Liçensa                                 | 20      | 8             | 40.0         |
| 6   | Blerje paisje kompjuterike                     | 3       | 0             | 0.0          |
|     |                                                |         |               |              |

Treguesi i performancës/produktit “Njësi statistikore të vrojtura” është realizuar 84.1% e planit vjetor.  
Në zbatim të V.K.M Nr. 32 datë 19.01.2022 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022 për financimin e programit të Këshillimit Kombëtar” janë realizuar 436,068 njësi statistikore.  
Treguesi i performancës/produktit “Të dhëna të publikuara” është realizuar 98.8%.  
Treguesi i performancës/produktit “Personel i trajnuar” është realizuar 91.5%.  
Treguesi i performancës/produktit “Auditime të kryera” është realizuar 85.7%.  
Treguesi i performancës/produktit “Blerje Liçensa” është realizuar 40%.  
Treguesi i performancës/produktit “Blerje paisje kompjuterike” nuk është realizuar.


**Realizimi i shpenzimeve sipas zërave për periudhën Janar-Dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:**

| Mijë /lekë |                                         |                    |                          |                  |                          |
|------------|-----------------------------------------|--------------------|--------------------------|------------------|--------------------------|
| Art        | SHPENZIMET                              | Plani vjetor       | Plani vjetor i rishikuar | Fakti 12-mujor   | % e Realizimit plan/fakt |
| 600        | Paga, sigurime shoqërore e shendetësore | 618,973.0          | 494,598.7                | 489,927.6        | 99.1                     |
| 602        | Mallra dhe shërbime te tjera            | 649,427.0          | 64,101.7                 | 59,879.5         | 93.4                     |
| 231        | Investime                               | 700,000.0          | 186,500.0                | 181,861.8        | 97.5                     |
|            | Te ardhura jashte limitit               | 0                  | 0                        | 9,111.8          | 0.0                      |
|            | <b>Totali</b>                           | <b>1,968,400.0</b> | <b>745,200.4</b>         | <b>740,780.7</b> | <b>99.4</b>              |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Pesha specifike sipas zërave mbi totalin e tyre, paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:



**Referuar Regjistrimit të Realizimeve të Prokurimeve Publike, për periudhën Janar-Dhjetor 2022 janë realizuar gjithsej:**

➤ **Janë ndjekur dhe realizuar procedurat e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, si më poshtë:**

1. Blerje liçenca
2. Shërbim mirëmbajtje/rinovim licencash
3. Shërbim mirëmbajtje pajisje kompiuterike
4. Botim shtypshkrime për INSTAT.

➤ **Procedura prokurimi – Blerje me vlerë të vogël, si më poshtë:**

- 1- Blerje bazë materiale (elektrike, hidraulike dhe telekomunikacioni)
- 2- Blerje siguracion godine - pajisje
- 3- Blerje siguracion për automjete
- 4- Shërbim larje automjesh
- 5- Blerje ujë, kafe, dhurata etj., për pritje delegacione
- 6- Shërbim monitorimi mediatik
- 7- Mirëmbajtje/Rinovim Liçenca – Fortinet
- 8- Hostim i faqes së aplikacionit për Sistemi WebGIS, INSTAT publikime.
- 9- Blerje materiale higjeno-sanitare
- 10- Shërbim profilaktik dhe riparim automjesh
- 11- Blerje bileta avioni.
- 12- Mirëmbajtje programi Alpha.
- 13- Blerje goma dhe bateri për automjete.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

➤ **Janë ndjekur dhe realizuar procedurat e prokurimit me donatorë, si më poshtë:**

- 1- Census at School
- 2- Blerje Gjeneratori
- 3- Kontraktimi i ekspertit për projektin S.P. 6.1
- 4- Printim Pyetësorësh
- 5- Fushata Publicitare
- 6- Blerje bileta avioni
- 7- Mirëmbajtjen e sistemit IT Backup
- 8- Mirëmbajtjen e sistemit IT Backup
- 9- Kontraktimi i Kompanisë Audituese për verifikimin e shpenzimeve financiare në kuadër të Grantit nën “Programin e Bashkëpunimit Statistikor IPA 2019 me Shumë Përfitues”
- 10- Publicity Campaign.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**  
**Alban ÇELA**